



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
**OSNOVNI SUD UROŠEVAC – BASIC COURT OF FERIZAJ**

---

**ADGJTHFR.1/24**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, kryetari i gjykatës Mustaf Tahiri, duke vendosur në çështjen disiplinore, sipas ankesës për iniciimin e procedurës disiplinore të parashtruar nga pala ankuese A.R. nga fshati ... – Komuna Ferizaj, me pretendimin për shkelje disiplinore nga gjyqtari i Gjykatës Themelore në Ferizaj B.S., në bazë të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, si dhe nenit 6, 7 paragrafi 3 të Rregullores nr.05/19 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, më 12 shkurt 2024, mori këtë:

**V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar kërkesa për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit të Gjykatës Themelore në Ferizaj B.S., e paraqitur nga pala ankuese A.R., për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për shkelje disiplinore.

**A r s y e t i m i**

Gjykata Themelore në Ferizaj përkatësisht autoriteti kompetent i kësaj gjykate - kryetari i gjykatës Mustaf Tahiri, *(në tekstin e mëtejme autoriteti kompetent)*, më 26 janar 2024 ka pranuar ankesën e ushtruar nga ankuesi A.R., kundër gjyqtarit të Gjykatës Themelore në Ferizaj B.S.

Ankuesi A.R., në ankesën e tij të ushtruar thekson se: ka pasur një rast në kundërvajtje tek gjyqtari B.S., e cila lëndë i`u është parashkruar pa mbajtur asnjë seancë dëgjimore me palë, duke shtuar tutje se konsideron se kjo bie ndesh sepse i njëjtë ka mbetur i dëmtuar nga ky gjyqtar i cili lëndën e ka lënë të i`u parashkruahet. Ankuesi tutje në ankesën e tij theksoi se gjyqtarit i ka thënë të dërgoj

lëndën në super ekspertizë në Prishtinë, mirëpo kur i njëjti është interesuar pas një viti, lënda nuk ishte dërguar në ekspertizë dhe është lënë me qëllim që të parashkruhet.

Gjyqtari i ngarkuar me këtë çështje B.S., në deklaratën e tij me shkrim lidhur me pretendimet e palës ankuese, ka theksuar se: më datë 7 dhjetor 2021, ka caktuar seancën gjyqësore por meqenëse vet i pandehuri ka parashtruar, parashtrësë – kërkesë për shtyrjen e seancës, i njëjti e ka shtyrë. I pandehuri kishte të autorizuar mbrojtësin e tij av. Liman Musa dhe me datë 21 dhjetor 2021, gjyqtari ka mbajtur seancën gjyqësore me të cilin i pandehuri nuk ka pranuar fajësinë për veprën për të cilën është ngarkuar dhe po ashtu edhe mbrojtësi i tij ka dhënë disa vërejtje rreth përshkrimit të vendit të ngjarjes dhe njëherit ka kërkuar që lënda të dërgohet në ekspertizë të komunikacionit. Tutje ka deklaruar se pas propozimit të mbrojtësit të të pandehurit për dërgimin e lëndës në ekspertizë, gjyqtari ka caktuar ekspertin e komunikacionit F.S., i cili ka marrë lëndën dhe e ka përgatit për ekspertizë.

Ndërkaq, pas dërgimit të ekspertizës mbrojtësit të të pandehurit av. Liman Musa dhe të pandehurit A.R., gjyqtari i çështjes përmes shkresës ka theksuar se ju ka dhënë mundësinë atyre që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, përmes parashtrësës të kundërshtojnë ekspertizën si provë dhe pas pranimit të kundërshtimit nga ana e mbrojtësit të të pandehurit av. Liman Musa më datë 13 korrik 2022 është mbajtur seancën e radhës në të cilën kanë prezantuar ekspertin, me çrast mbrojtësi i të pandehurit ka kundërshtuar ekspertizën, duke i thënë se: “ju nuk jeni i licencuar” dhe për këtë unë kam sjellë një ekspertizë nga eksperti i licencuar F.H. nga Vitia me numër të licencës AGJ.nr.62/2009, për të cilën gjyqtari ka theksuar se ka pasur dyshime e tij për shkak të paraqitjes së gjendjes faktike krejtësisht të kundërt me atë të ekspertit të caktuar nga ana e gjykatës.

Gjyqtari i kësaj çështjes B.S. ka theksuar se për arsyet e lartë shënuara i njëjti ka pritur që në momentin e marrjes së listës së ekspertëve të licencuar, t'ia dërgoj lëndën tek ndonjëri nga ekspertët e licencuar, por meqenëse nuk premtonte koha për shkak të afatit të shkurtër të parashkrimit, lënda është parashkruar por pa asnjë qëllim për ta dëmtuar palën.

Gjyqtari në deklaratë ka theksuar po ashtu se i pandehuri shërbehet me të pavërteta, dhe se aludimi i të pandehurit – parashtruesi të ankesës se gjoja “nuk kam mbajtur asnjë seancë dëgjimore me

palët” nuk është aspak i vërtetë, ngase përpos shkresave të lëndës, veprimet e gjyqtarit mund të shihen edhe përmes procesverbaleve të cilat janë të regjistruar në SMIL.

Kryetari i Gjykatës Themelore në Ferizaj, si autoritet kompetent pas shqyrtimit dhe vlerësimit të pretendimeve të palës ankuese, vlerësimit të deklaratës së gjyqtarit të rastit si dhe shkresave tjera të lëndës ka ardhur në përfundim se nuk ka bazë të arsyeshme për shkelje disiplinore nga gjyqtari B.S..

Kryetari i Gjykatës vlerëson se pretendimet e palës ankuese në rastin konkret nuk qëndrojnë, nga faktet të cilat gjenden në shkresa të lëndës vërtetohet se gjyqtari B.S., lëndën e ka pranuar me datë 13.04.2021, dhe i njëjti me datë 07.12.2021 ka ndërmarrë veprime duke e caktuar seancën, e cila me kërkesën e të pandehurit është shtyrë, dhe përsëri me datë 21.12.2021 është caktuar dhe mbajtur seanca gjyqësore. Po ashtu janë ndërmarrë veprime ku është urdhëruar ekspertiza e komunikacionit, dhe përsëri me datë 13.07.2022, është mbajtur seanca gjyqësore ku është kontestuar ekspertiza e komunikacionit nga mbrojtësi i të pandehurit dhe po ashtu është paraqitur si provë edhe ekspertiza e sjellur nga mbrojtësi i të pandehurit, dhe si rrjedhojë e procedurës është propozuar superekspertizë nga lëmi i komunikacionit, mirëpo për shkak të afatit të shkurtë kohorë të parashkrimit në procedurë kundërvajtëse e që ky afat është dy (2) vite, gjyqtari me aktvendimin K.nr.1081/21 datë 25.08.2023 ka përfunduar procedurën kundërvajtëse ndaj të pandehurit A.R., për shkak të parashkrimit absolut të procedurës kundërvajtëse.

Autoriteti kompetent po ashtu ka vlerësuar edhe ngarkesën me lëndë që gjykata ka pas në lëmin kundërvajtëse, gjegjësisht gjyqtari, ku nga të dhënat e siguruar përmes sistemit SMIL nga periudha e datës 28.03.2021, kur është pranuar në këtë gjykatë kërkesa për procedurën kundërvajtëse ndaj të pandehurit A.R., e deri në kohën kur gjyqtari ka nxjerr aktvendimin për përfundimin e çështjes me datë 25.08.2023, gjyqtari i çështjes për këtë periudhë ka pranuar një numër të madhe të lëndëve (2486 lëndë) dhe se edhe përkundër gjithë kësaj ngarkese me lëndë, gjyqtari është përpjekur ti ndërmerr veprimet procedurale brenda afatit të përcaktuar ligjor, por për shkak të afateve të shkurta kohore të parashkrimit në procedurën kundërvajtëse çështja konkrete ka arritur parashkrimin absolut, andaj në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me veprime apo neglizhencë të qëllimshme të gjyqtarit siç është theksuar nga ankuesi, por duke pasur parasysh edhe rrethanat objektive në të cilat është gjendur gjyqtari me ngarkesën me lëndë në këtë periudhë,

ka mundur edhe të vije deri te parashkrimi i kësaj çështje por jo duke e neglizhuar apo duke vepruar qëllimshëm nga ana e gjyqtarit, siç ka pretenduar ankuesi.

Andaj, bazuar në nenin 9 paragrafi 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, si dhe nenit 6, 7 paragrafi 1 dhe 3 pika 3.2 të Rregullores nr.05/19 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, si dhe bazuar në të dhënat e përshkruara si më lartë Autoriteti Kompetent vlerëson se nuk ka bazë të arsyeshme të besoj se gjyqtari ka kryer shkelje disiplinore, për ti parashtruar Këshillit Gjyqësor të Kosovës kërkesë për fillim të hetimeve disiplinore.

Nga arsyet e shpjeguara më lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

## **GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

**ADGJTHFR.1/24**

**12 shkurt 2024**

**Mustaf TAHIRI**

---

**Kryetar i Gjykatës**

### **Iu dërgohet:**

A.R., fshati ... – Komuna Ferizaj - Parashtrues i ankesës

B.S. - Gjyqtar

Këshillit Gjyqësor të Kosovës